



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN

KESHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I FINANCAVE, BUXHETIT DHE ASETETEVE PUBLIKE

RAPORT VENDIMARRJE

Nr 55, Datë 22/ 06/ 2026

Lënda: Vendim për shqyrtimin e Projekt-vendimit nr.....datë,/...../2026, “Per miratimin e Programit Buxhetor Afatmesem (PBA) 2027-2029, faza e pare, Bashkia Elbasan”

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Elbasan

Hyrje

Ky projekt-vendim paraqitet nga Drejtoria e Pergjithshme.Fiance Buxhetit, dhe ka për qëllim:

BAZUESHMERIA LIGJORE DHE VOTIMI	<i>Hartimi i tavanëve përgatitore të shpenzimeve, të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029, është bazuar në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", si dhe udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit vendor. Gjithashtu, në hartimin e programit buxhetor afatmesëm 2027-2029, Bashkia Elbasan është bazuar në Udhëzimin nr.7, datë 27.02.2026 të Ministrisë së Financave "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2027-2029".</i>
SITUATA AKTUALE E FUNKSIONIT	<i>PBA 2027-2029 bazohet në vizionin e Bashkisë për Elbasanin, i cili duhet të jetë një qytet lehtësisht i jetueshëm, me infrastrukturë moderne, me shërbime efikase dhe cilësore, me mundësi investimi për sipërmarrësit, me jetë kulturore e sportive të larmishme, me hapësira të gjelbërta të dedikuara për fëmijët dhe të moshuarit. Procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzime korente, duke na siguruar një bazë të fortë mbi të cilën mund të marrim vendime për investime, në lidhje me planet strategjike afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike. Objektivi themelor i PBA është përmirësimi në vazhdim i cilësisë së jetesës në qytetin e Elbasanit, nëpërmjet mbrojtjes së mjedisit, rritjes së sigurisë në rrugë e në objektet shkollore, përmirësimit të kushteve në çerdhe, kopështe e shkolla, ofrimit të shërbimeve sociale cilësore, rritjes së punësimit dhe</i>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN

KESHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I FINANCAVE, BUXHETIT DHE ASETETEVE PUBLIKE

	<p>zhvillimit të ekonomisë rurale, turizmit, etj. Parashikimi i të ardhurave e shpenzimeve është bazuar në: 1. Paketën fiskale të Bashkisë Elbasan, miratuar me vKB nr.140, datë 27.12.2025. 2. Shpërndarjen e burimeve në përputhje me prioritetet e zhvillimit të qytetit. 3. Prioritetet e qytetarëve të evidentuara gjatë takimeve në çdo lagje, apo njësi administrative. Shtyllat kryesore në të cilat është mbështetur hartimi i tavanëve të PBA 2027-2029, janë: Zhvillimi ekonomik i qytetit dhe nxitja e punësimit; Garantimi i pastërtisë së qytetit dhe i cilësisë së ajrit; Ofrimin e shërbimeve cilësore; Përmirësimin e infrastrukturës arsimore; Përmirësimin e infrastrukturës rrugore; Nxitjen dhe mbështetjen e aktiviteteve sportive, të cilat ndikojnë në shëndetin e popullatës; 2 Gjallërimi i jetës kulturore dhe artistike, nëpërmjet mbështetjes së projekteve; Mbështetja e trashëgimisë kulturore dhe e turizmit.</p>
SITUATA FINANCIARE (Impakti financiar, shtesa pakësime në buxhet)	<p><u>Plani i te ardhurave 2027-2029</u> Te ardhurat nga burimet e veta viti 2027-1,781,774 mije leke, viti 2028-1,817,255 mije leke, viti 2029-1,853,338 mij leke Tansferta e pakushtezuar viti 2027-1,296,667 mije leke, viti 2028-1,359,029 mij leke, viti 2029-1,421,780 mije leke Transferta specifike viti 2027-777,372 mije leke, viti 2028-792,919 mije leke, vit 2029-800,848 mije leke. Te ardhura jashte limitit viti 2027-29,784 mije leke, viti 2028-30,380 mije leke, vit 2029-30,98 mije leke <u>Totali i te ardhurave:</u> viti 2027-3,885,597 mije leke, viti 2028-3,999,583 mije leke, vit 2029-4,107,053 mije leke <u>Plani i shpenzimeve:</u> - Shpenzimeve për personelin, në vitin 2027 është parashikuar rritje me 2.5 perqind krahasuar me fondet për vitin 2026, bazuar në VKM- në nr. 87, datë 06.02.2026 "Për disa ndryshime në vendimin nr.326, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike, të ndryshuar". Per vitin 2028 është parashikuar të ruhet i njëjti nivel i pagave si në vitin 2027, ndërsa në vitin 2029 është</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN

KESHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I FINANCAVE, BUXHETIT DHE ASETETEVE PUBLIKE

	<p>parashikuar rritje me 2.5 % krahasuar me vitin 2028, bazuar në ligjin 35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", neni 8, pika b, në të cilin citohet masa e indeksimit të pagave të të punësuarve në institucionet e administratës publike, jo më vonë se dy vjet nga indeksimi i fundit, bazuar në nivelin e inflacionit.</p> <p>- Shpenzime të tjera korrente, në programin "Menaxhimi dhe shërbimet mbështetëse", shpenzimet operative për administratën janë ulur me rreth 12,6 përqind për vitin 2027, krahasuar me vitin 2026, duke e ruajtur këtë nivel me ulje për dy vitet e ardhshme 2028-2029. Për shpenzimet në mbrojtjen e mjedisit si dhe për emergjencat civile, të cilat janë planifikuar me rritje në të tre vitet e ardhshme. Mbështetur në nenin 65 të ligjit nr.45/2019 "Për 4 mbrojtjen civile", shpenzimet për emergjencat civile llogariten në 4 përqind të planit të të ardhurave dhe transfertës së pakushtëzuar. Në zbatim të këtij vendimi, shpenzimet janë llogaritur 4 përqind mbi planin e të ardhurave dhe meqenëse të ardhurat e veta vendore dhe transfertat e pakushtëzuar (granti) janë në rritje, edhe shpenzimet për emergjencat civile janë planifikuar me rritje 2.7 përqind 2.9 përqind, e reflektuar në tavanet përgatitore të shpenzimeve, në programin AB109 (Rendi dhe siguria Publike), për çdo vit të periudhës afatmesme. Për të gjitha programet e tjera, në përgjithësi është ruajtur i njëjti nivel me vitin 2026,</p> <p>-Shpenzimet kapitale për vitin 2027 janë planifikuar në vlerën 753,219 mijë lekë, për vitin 2028 në vlerën 859,214 mijë lekë, ose 14 përqind më shumë se viti 2027, vitin 2029, në vlerën 909,800 mijë lekë, ose 6 përqind më shumë se viti 2028. Investimet janë përqëndruar kryesisht në përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe në arsim, pa lënë mënjanë programet e tjera, duke shtrire investimet në të gjitha funksionet. Investime janë parashikuar për programet: "Rendi dhe siguria publike", "Mbrojtja e mjedisit", "Zhvillimi Urban dhe Shërbimet Publike", etj. Rëndësi është treguar në rikonstruksionet dhe ndërtimin e çerdheve të reja, pjesë e programit "Mbrojtja sociale".</p> <p><u>Totali i shpenzimeve:</u> viti 2027-3,885,597 mije leke, viti 2028-3,999,583 mije leke, vit 2029-4,107,053 mije leke</p>
DREJTORIA PËRGJEGJËSE	Drejtoria e Finance Buxhetit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I FINANCAVE, BUXHETIT DHE ASETETEVE PUBLIKE

RAPORTIMI DHE MONITORIMI	Administrata e Bashkise do te beje raportimin per Keshilli Bashkiak sipas te gjithe kalendarit te procesit te hartimit te PBA 2027-2029 deri ne miratimin ne tij ne fund te vitit 2026.
IMPAKTI SOCIAL DHE GRUPET QË PREKEN	Ne tavanet buxhetore 2026-2028 jane konsideruar dhe adresohen te gjitha ceshtjet sociale te komunitetit, veçanerisht per personat me aftesi te kufizuara, pensionistet, te pastrehet, njerezit e vetmuar si dhe grupet vulnerabel – komuniteti Rom dhe Egjiptian, etj.
KONSULTIMI PUBLIK	Konsultimet publike per tavanet buxhetore 2027-2029 u zhvilluan ne muajt Prill dhe Maj 2026


Komisioni i Përhershëm i Financave, Buxhetit dhe Aseteve Publike, i mbledhur më datën 22/06/2026 pasi shqyrtoi projekt-vendimin, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI:


1. Ti propozojë Këshillit Bashkiak:
 - a. Kalimin e projekt aktit në mbledhjen e këshillit për vlerësim të mëtejshëm për vlerësim dhe miratim.
 - b. **Miratimin e projektaktit**
 - c. Refuzimin e miratimit të Projektaktit
 - d. Ti kerkoje drejtorise perkatese informacion shtese per projektvendimin
 - e. Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
 - Pika e projektvendimit të ndryshojë në “ _____ ”
 - Pika e projektvendimit të ndryshojë në” _____ ”
 - Tabela e projektvendimit të ndryshojë në“ _____ “
 - Paragrafi i projektvendimit të ndryshojë në “ _____ ”


Bashkëlidhur argumentat e Vendimarrjes dhe mendimi i pakicës i parqitur në procesverbalin e Komisionit


Kryetari i Komisionit: Shefqet Bullari 

Enkryetar i Komisionit: Doris Madhi

Sekretar i Komisionit:

Anetar i Komisionit: Bukurosh Stafa 

Anetar i Komisionit: Ermira Urupi 

Anetar i Komisionit: Imelda Sejdini 

Anetar i Komisionit: Eugen Isaj 